

MARREVESHJE

Mbi bashkimin me perthithje te shoqerise

“ Saer Medical ” SHPK nga

shoqeria ” Health&Light ” SHPK

Në Tiranë, sot më datë 06/02/2024 në selinë e shoqërisë “Health&Light ‘ Shpk, që ndodhet në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga”Themistokli Gërmenji” Nd. 11, Shkalla 4, Ap.4, Tiranë, hartohet kjo marrëveshje për bashkimin e kësaj shoqërie me shoqërinë “Saer Medical” Shpk.

Bashkimi do të kryhet në formën e përthithjes të njëres shoqëri nga një shoqëri ekzistuese.

Bazuar ne ligjin nr 9901 date 14/04/2008 “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare” i ndryshuar dhe ne zbatim te neneve 215 -224, lidhet kjo projekt-marreveshje midis perfaqesuesit ligjor te ”Saer Medical” SHPK zotit Ridi Cipo dhe perfaqesuesit ligjor te ”Health&Light” SHPK zotit Ridi Cipo, me objekt bashkimin me perthithje te ketyre subjekteve private. Nga diskutimet e çeshtjeve te ndryshme per bashkimin, kapitalet, punesimin e vazhdimin e funksionimit, etj. midis paleve u arriten keto konkluzione:

1. Drejtimi i bashkimit

a. Shoqëria përthithëse:

Health&Light shpk me NIPT: L42231011L

Kapitali i regjistruar 100 lekë

Selia: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga”Themistokli Gërmenji” Nd. 11, Shkalla 4, Ap.4, Tiranë

Ortakë:

- Petrit Vargu, që zotëron 100% kuota me vlerë nominale 100 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.

b. Shoqëria e përthithur


Saer Medical shpk me NIPT: K31610086D

Kapitali i regjistruar 20,000,000.00 lekë

Selia: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga”Themistokli Gërmenji” Pall. Në krah të RTSH-së, Kati i I-rë, Tiranë

Ortakë:

Petrit Vargu, që zotëron 100% kuota me vlerë nominale 20,000,000.00 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.



SAER MEDICAL Shpk
Rr. Themistokli Gërmenji
TIRANë ALBANIA

2. Motivet dhe qëllimi i bashkimit


Qëllimi dhe motiv i bashkimit është menaxhimi më i mirë i aktivitetit ekonomik e financiar, përdorimi me më shumë efektivitet i mjeteve financiare, zgjerimi i aktivitetit nëpërmjet përthithjes së aktivitetit të Shoqërive, duke realizuar në këtë mënyrë shtimin e produktit të ri, përballimin e konkurrencës në treg dhe për rrjedhojë rezultate më të mira të fitimit. Më poshtë po rëndisim aspektet kryesore të këtij bashkimi:

- Shoqëria përfituese e kontributeve ose shoqëria përthithëse në përfundim të këtij procesi do të ruajë emrin shoqëria **"Health&Light" shpk.**
- Selia e Shoqërisë përfituese të kontributeve do të jetë në **Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga "Themistokli Gërmenji" Nd. 11, Shkalla 4, Ap.4, Tiranë**
- Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë të përthithur, "Saer Medical" Shpk, mbas përfundimit të operacionit i kalojnë Shoqërisë përthithëse **"Health&Light" shpk.**
- Shoqëria e përthithur "Saer Medical" shpk, si shoqëri e përthithur nga shoqëria "Health&Light" shpk, në përfundim të këtij operacioni do të përthithet pa likuidim duke kaluar plotësisht trashëgiminë e saj ekonomike, financiare dhe ligjore tek shoqëria përthithëse, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit.
- Data 1 janar 2023 do të quhet sipas Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" në aspektin e kontabilitetit si data e bashkimit të shoqërive.
- Data 31 dhjetor 2022 është data në të cilën janë hartuar pasqyrat financiare për efekt të bashkimit, dhe që janë përdorur për këtë qëllim.

3. Aktivitet dhe Pasivitet e parashikuara për tu bashkuar

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi, shoqëria "Saer Medical" shpk, si shoqëri e përthithur, i transferon shoqërisë "Health&Light" shpk, si shoqëri përthithëse, tërësinë e elementeve të aktivitetit dhe të pasivitetit ashtu si rezultojnë në bilancin e datës 31 dhjetor 2022. Elementët e aktivitetit dhe të pasivitetit që do të kalojnë nga shoqëria e përthithur në shoqërinë përthithëse paraqiten në Pasqyrat Financiare të Bashkimit. Në këtë tabelë paraqitet dhe bilanci i përbashkët dhe mbas realizimit të operacionit të bashkimit.

4. Shoqëria "Health&Light" SHPK pranon të përthithë shoqërinë "Saer Medical" SHPK duke bashkuar pasurinë e të dy subjekteve në shoqërinë "Health&Light" SHPK dhe ortakët do të marrin aksione në këmbim të kapitalit që ata zoterojnë.
5. Shoqëria "Health&Light" SHPK është shoqëri që ka një kapital prej 100 leke dhe që zotërohet nga Petrit Vargu i cili pranon të ketë marrëdhënie këmbimi të kuotes me ortakun aktual të shoqërisë "Saer Medical" SHPK zotin Petrit Vargu, i cili është i njëjti person, me një kapital prej 20.000.000 leke.
6. Shoqëria përthithëse "Health&Light" SHPK do të ketë një kapital prej 20.000.100 leke dhe i gjithë kapitali do të bashkohet në një kuotë të vetme pasi ortak i vetëm për të dy shoqëritë është i njëjti person, zoti Petrit Vargu.
7. Shoqëria përthithëse "Health&Light" SHPK i njeh si më sipër të drejta të barabarta



SAER MEDICAL Shpk
Rr. Themistokli Gërmenji
TIRANË ALBANIA

zotit Petrit Vargu i ardhur si ortak i vetem i shoqërise “Saer Medical” SHPK.

Mbas procedurave të bashkimit do të kemi një shoqëri të vetme “Health&Light” shpk.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përthithëse pas bashkimit do të jetë 20.000.100 lekë i përbërë nga:

- Petrit Vargu, që zotëron 100% kuota me vlerë nominale 20.000.100 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.

Shoqëria “Health&Light” shpk, gëzon frutet e kontributit të shoqërisë “Saer Medical” shpk duke filluar nga data e realizimit të bashkimit në fjalë.

Selia e shoqërisë përfituese të kontributeve do të jetë Selia: **Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga “Themistokli Gërmenji” Nd. 11, Shkalla 4, Ap.4, Tiranë.**

Përfaqësues ligjor i shoqërisë do të jetë Z. Ridi Cipo.

1. Data kontabël

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej shoqërive të përthithura do të merren në librat e shoqërisë përthithëse nga data 01.01.2023 përsa i përket pasqyrës të të ardhurave dhe shpenzimeve. Nga ana tjetër regjistrimi i aktiveve dhe pasiveve në librat e shoqërisë përthithëse do të bëhet sipas bilancit të datës 31.12.2022.

2. Të drejta dhe avantazhe të veçanta

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë. Ky bashkim hartohet e nënshkruhet në kushtin e varësisë së miratimit nga asambleja e përgjithshme e secilës prej shoqërive pjesëmarrëse pas datës 28.04.2023, përkatësisht me vendimet e datës 28.04.2023.

3. Funksionimi i Shoqërisë Përthithëse “Health&Light” shpk

Shoqëria “Health&Light” shpk do të vazhdojë të funksionojë me Aktin e themelimit dhe Statutin e saj.

4. Pasoja për të punësuarit pas bashkimit.

Marrëdhëniet juridike me të punësuarit e shoqërisë së përthithur, janë mbartur më 01.01.2023, shoqëria përthithëse dhe marrëdhënia e punës do të vazhdojë rregullisht edhe Pas përfundimit të procesit të bashkimit, deri në përfundim të kontratave të punës të lidhura me të punësuarit.

5. Marrëdhëniet me të Tretët



SAER MEDICAL Shpk
Rr. Themistokli Gërmenji
TIRANë ALBANIA



Marrëdhëniet juridike të shoqërisë së bashkuar me të tretët, (të krijuara para bashkimit), do të mbarten në shoqërinë përthithëse dhe detyrimet që burojnë nga këto kontrata do të përmbushen nga shoqëria përthithëse.

6. Marrëdhëniet me Organet Shtetërore

Marrëdhëniet juridike të shoqërisë së bashkuar me Organet Shtetërore, (të krijuara para bashkimit), do të mbarten në shoqërinë përthithëse dhe detyrimet që do të rezultojnë për shoqëritë e përthithura deri në mbarimin e tyre si person juridik do të përmbushen nga shoqëria Përthithëse.

Për shoqërinë "Health&Light" shpk
Administratori

Ridi Cipo



Për shoqërinë "Saer Medical" Shpk
Administratori

Ridi Cipo

